 26. Dosje O.R.V. “Instituti Studimeve dhe Projekteve” nr. 3, me 3 fashikuj, në total me 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
 27. Dosje O.R.V. “Hotel Dajti” nr. 734, me 3 fashikuj, në total 237 (dyqind e tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
 28. Dosje Objekti “Uzina Dinamo” nr. 266, me 3 fashikuj, në total 109 (njëqind e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
 29. Dosje e problemit të centralizuar “Dhelpra” nr. 842, me 217 (dyqind e shtatëmbëdhjetë) fletë. Niveli

i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Dega IV.

30. Dosje formulare nr. 1674, në ngarkim të Xh. A., me 179 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
31. Dosje formulare nr. 8243, në ngarkim të T. Gj., me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
32. Dosje O.R.V “Rinas” nr. 1031, me 3 fashikuj, në total 242 (dyqind e dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
33. Dosje formulare nr. 2561, në ngarkim të I. B., me 458 (katërqind e pesëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Drejtoria e II-të.
34. Dosje formulare nr. 146, në ngarkim të Xh. S., me 2 volume, në total me 653 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Operativ.
35. Dosje O.R.V “Kombinati i Tekstileve” nr.77, me 4 fashikuj, në total 372 (treqind e shtatëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
36. Dosje O.R.V “Kombinati i Drurit Misto Mame” nr. 410, me 5 fashikuj, në total 337 (treqind e tridhjetë e shtatë) fletë dhe një fletore me shënime me 54 (pesëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me Vendim nr. 17, datë 5.11.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me Vendim nr. 17, datë 5.11.2021, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

- I. Deklasifikim i plotë i dosjeve:
 1. Fletore shënimesh nr.28 datë 8.11.1985, në ngarkim të A. M., me 80 (tetëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Fletorja i përket fondit ish Ushtria.
 2. Fletore shënimesh nr.54 datë 7.2.1986, në ngarkim të A. M., me 120 (njëqind e njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Fletorja i përket fondit ish Ushtria.
 3. Fletore shënimesh nr.20 datë 29.10.1985, në ngarkim të A. M., me 74 (shtatëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Fletorja i përket fondit ish Ushtria.
 4. Dosje gadishmërie e Sigurimit të repartit nr. 5845 Fier, me nr.42, në ngarkim të A. M., me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret i Rëndësisë së veçantë”. Dosja i përket fondit ish Ushtria.

5. Dosje e informatave nr. 62, në ngarkim të A. M., me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Ushtria.
6. Fashikull nr. 1 nga dosja e objektit nr. 6, në ngarkim të A. M., me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Fashikulli i përket fondit ish Ushtria.
7. Vendim i Sigurimit të Repartit Usharak nr. 6561, nr. 147 datë 23.12.1989, për heqjen nga rrjeti informativ të bashkëpunëtorit "skifteri" dhe veçimi i dosjes për asgjësim, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret A. Res. Personal". Dokumenti i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Lushnje.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me Vendim nr. 18, datë 5.11.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara "sekret shtetëror", me Vendim nr. 18, datë 5.11.2021, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

- I. Deklasifikim i plotë i dosjeve:
 1. Dosje pune nr. 7451 "Fusha e madhe", me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Durrës.
 2. Dosje formulare dhe fashikull personal për të dënuarin nr. 4639, në ngarkim të S.P., me 122 (njëqind e njëzet e dy) fletë dhe 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Fier.
 3. Dosje përpunimi nr. 401, në ngarkim të H. B., me 49 (dyzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Korçë.
 4. Dosje formulare nr. 881, në ngarkim të M. M., me 70 (shtatëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Kukës.
 5. Dosje përpunimi nr. 2565 dhe fashikull personal për të dënuarin, në ngarkim të E. M., me 84 (tetëdhjetë e katër) dhe 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Drega e Punëve të Brendshme Fier.
 6. Dosje e problemit të centralizuar nr. 500 "Fani", me 151 (njëqind e pesëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega IV.
 7. Dosje formulare nr. 9403 në ngarkim të P. D., me 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
 8. Dosje personale dhe pune nr. 2916 në ngarkim të A. Z., me 38 (tridhjetë e tetë) dhe 94 (nëntëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Pogradec.

9. Dosje përpunimi nr. 12247, në ngarkim të M. C., me 189 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja i përket fondit ish "Të Huajt".
 10. Dosje formulare nr. 237, në ngarkim të N. S., me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket ish fondit Operativ.
 11. Dosje formulare nr. 7984, në ngarkim të O. K., me 54 (pesëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket ish fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
 12. Dosje përpunimi nr. 6097 dhe fashikull për të dënuar në ngarkim të E. L., me 126 (njëqind e njëzetë e gjashtë) + 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Kavajë.
 13. Fashikull nr. 10000 në ngarkim të R. G., me 21 (njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket ish fondit Kosova.
 14. Fashikull nr. 12120 në ngarkim të R. G., me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket ish fondit Kosova.
 15. Fashikull nr. 5335 në ngarkim të R. G., me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket ish fondit Kosova.
 16. Fashikull nr. 4156 në ngarkim të R. G., me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket ish fondit Kosova.
- II. Deklasifikimin pjesësisht të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" që gjendet në dokumentin si më poshtë:
1. Regjistër agjente Model 2, nr. 2 datë 10.01.1987 me 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë, fillon me numër rendor 2 dhe mbaron me numër rendor 3631, nga të cilat 25 fletë të plotësuar. Niveli i klasifikimit të regjistrit është "Sekret". Regjistri i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Pogradec.
 2. Regjistër agjente Model 10, nr.9 dt 10.01.1987 me 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë nga të cilat 18 fletë janë me të dhëna. Niveli i klasifikimit të regjistrit është "Sekret". Regjistri i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Pogradec.
 3. Regjistër agjente nr. 31, Model 2, me 196 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) fletë, fillon me numër rendor 22 dhe mbaron me numër rendor 6266. nga të cilat 46 fletë janë të plotësuar. Niveli i klasifikimit të regjistrit është "Sekret". Regjistri i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me Vendim nr. 19, datë 5.11.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara "sekret shtetëror", me Vendim nr. 19, datë 5.11.2021, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

I. Deklasifikim i plotë i dosjeve:

1. Dosje O.R.V. "Miniera dhe Kromi" nr. 624, me 2 volume, në total me 132 (njëqind e tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Dibër.
2. Dosje O.R.V. "Pusi" nr. 624, me 2 volume, në total me 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Dibër.
3. Dosje O.R.V. "Fabrika e pasurimit të kromit" nr. 633, me 2 volume, në total me 68 (gjashtëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Dibër.
4. Dosje O.R.V. "Ndërmarrja Gjeologjike Bulqizë" nr. 7, me 2 volume, në total me 102 (njëqind e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Dibër.
5. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 262, "Relacione dërguar Udhëheqjes Partisë mbi arrestimin e grupit armiqësor të Gurrës Krujë, mbi aktivitetin armiqësor të disa të rinjve në Tiranë", me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1970.
6. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 290, "Kërkesa, informacion, letra nga kampe e burgje", me 97 (nëntëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1983.
7. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 402, "Korespondencë mes Degës VIII dhe Degëve të Punëve të Brendshme për internim dëbimet", me 112 (njëqind e dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1985.
8. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 357, "Propozime për internim dëbime e zgjidhje kërkesash të bëra nga D.P.B. Gjirokastër, Burrel, Peshkopi, Sarandë etj", me 163 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1984.
9. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 390, "Informacion për disa probleme shqetësuese në uzinën e Kombinatit Metalurgjik Elbasan", me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1990.
10. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 391, "Shkresë përcjellëse e dokumentacionit teknik të uzinës nr.12 të Kombinatit Metalurgjik Elbasan", me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1990.
11. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 392, "Për disa probleme në furnaltën nr. 2 të Kombinatit Metalurgjik Elbasan", me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1990.
12. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 394, "Për disa probleme në linjën eksperimentale të uzinës së metaleve në Kombinatit Metalurgjik Elbasan", me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1990.
13. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 395, "Për disa probleme shqetësuese në Kombinatit Metalurgjik "Çeliku i Partisë" Elbasan", me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1990.
14. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 396, "Për djegien e Fabrikës së Miellit Elbasan", me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1990.
15. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 468, "Për shkeljen e rregullave të mbrojtjes kundër zjarrit në Kombinatit Metalurgjik "Çeliku i Partisë" Elbasan", me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1990.
16. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 467, "Mbi disa probleme për kuptimin e mekanizmit të ri ekonomik në Kombinatit Metalurgjik "Çeliku i Partisë" Elbasan", me 4 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes

- është "Sekret". Dosja daton në vitin 1990.
17. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 228, "Për disa shqetësime në Kombinatin Metalurgjik "Çeliku i Partisë" Elbasan", me 41 (dyzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1988.
 18. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 153, "Informacion dërguar Udhëheqjes së Partisë mbi disa probleme e shqetësime në Kombinatin Metalurgjik në Elbasan", me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1982.
 19. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 216, "Informacione të Drejtorisë I-rë, për disa probleme në uzinën nr. 12 dhe pasojat negative që ka sjellë në Kombinatin Metalurgjik në Elbasan", me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1986.
 20. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 125, "Për disa persona të arratisur në Jugosllavi gjatë muajit mars-prill 1988", me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1988.
 21. Fondi 4, Drejtoria e I, Dosje nr. 92, "Dosje me historikun, plane masash, të dhëna agjenturore të tjera për një fis në rrethin Peshkopi", me 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitin 1962.
 22. Dosje formulare nr. 2222, në ngarkim të T. V., me 59 (pesëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Berat.
 23. Dosje personale dhe pune nr. 2149, në ngarkim të I. I., në total me 90 (nëntëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Lushnje.
 24. Dosje personale dhe pune nr. 3881, në ngarkim të Sh. D., në total me 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Lushnje.
 25. Dosje personale dhe pune nr. 4308, në ngarkim të R. G., në total me 343 (treqind e dyzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Lushnje.
 26. Dosje personale dhe pune nr. 1750/1, me 3 volume, në ngarkim të R. Ç., në total me 528 (pesëqind e njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Lushnje.
 27. Kartelë model 2, nr. 2868, me 1 (një) fletë, në ngarkim të H. V.. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret A.R.P.". Kartela i përket fondit ish Dega IV.
 28. Dosje personale dhe pune nr. 23, me 3 volume, në ngarkim të H. S., në total me 398 (treqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Lushnje.
 29. Dosje personale dhe pune nr. 3854, në ngarkim të S. G., në total me 134 (njëqind e tridhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Lushnje.
 30. Dosje formulare nr. 2025, në ngarkim të H. H., me 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Lushnje.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me Vendim nr. 20, datë 11.11.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara "sekret shtetëror", me Vendim nr. 20, datë 11.11.2021, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

I. Deklasifikim i plotë i dosjeve:

1. Drejtoria e I-rë, dosje nr. 99, "Procesverbal mbi dorëzimin e dosjeve hetimore e gjyqësore të grupit armiqësor të sabotatorëve, A. K. me bashkëpunëtorët e tij", 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret i Rëndësisë së Veçantë". Dosja daton në vitet 1977.
2. Dosje formulare nr. 1962, në ngarkim të A. K., me 109 (njëqind e nëtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja daton në vitet 1975-1977. Dosja i përket fondit ish Dega IV.
3. Fondi 4, Dosje nr. 191 "Dorëshkrime të A. K., me 227 (dyqind e njëzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja daton në vitet 1975-1977.
4. Fondi 4, Dosje nr. 192 "Dorëshkrime të A. K.", me 295 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja daton në vitet 1975-1977.
5. Dosje me 4 fashikuj, në total me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1984. Dosja i përket fondit ish Dega IV.
6. Fondi 4, Drejtoria I-rë, dosje nr. 473 "Mbi disa mbishpenzime gjatë punës për montimin e fabrikës së pllakave në Elbasan", me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitet 1990.
7. Dosje përpunimi nr. 1714, në ngarkim të Gj. M., me 187 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja daton në vitet 1974-1983. Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Lezhë.
8. Dosje agjenturore "Sorra" nr. 1196, në ngarkim të S. B., me 48 (dyzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja daton në vitet 1987-1988. Dosja i përket fondit ish Dega IV.
9. Dosje përpunimi nr. 3201, në ngarkim të S. B., me 209 (dyqind e nëtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja daton në vitet 1974-1990. Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Berat.
10. Dosje formulare nr. 2 dhe nr. 2/1, në ngarkim të S. S., me 2 volume, në total me 624 (gjashtëqind e njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja daton në vitet 1946-1990. Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Vlorë.
11. Fashikull nr. 574, në ngarkim të R. P., me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja daton në vitet 1959-1990. Dosja i përket fondit ish të Arratisur.
12. Dosje kërkimi dhe dosje formulare nr. 574, në ngarkim të Gj. N., me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja daton në vitet 1951-1968. Dosja i përket fondit ish të Arratisur.
13. Dosje agjenturore nr. 161 "Rrufeja", me 193 (njëqind e nëntëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja daton në vitet 1951-1973. Dosja i përket fondit ish Operativ.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula



VEPRIMTARI

TË AUTORITETIT PËR
INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH SIGURIMIT TË SHTETIT
PËR PERIUDHËN
NËNTOR-DHJETOR 2021

KËSHILLI BASHKIAK I ELBASANIT SHPALL “QYTETAR NDERI” ATË JOSIF PAPAMIHALIN ME PROPOZIM TË AUTORITETIT



Në 5 vjetorin e lumturimit të martirëve të Kishës Katolike nga Papa Françesku në Elbasan, më 5 nëntor, në teatrin “Skampa”, u përkujtua dhe u nderua me vlerësimin “Qytetar Nderi” pas vdekjes Atë Josif Papamihali, martir i Kishës Katolike.

Aktiviteti u organizua nga Qendra e Bashkëpunimit Ndërfetar, Bashkia Elbasan, Këshilli Bashkiak Elbasan dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Në hollin e teatrit “Skampa” u prezantua edhe ekspozita “Shekulli i Martirëve”, përgatitur nga “Platforma Europiane e Kujtesës dhe Ndërgjegjes”, në bashkëpunim me “Qendrën Memo”.

Pas përfundimit të ceremonisë të pranishmit, të shoqëruar edhe nga Famullitari Don Giusepe Testa, zhvilluan një vizitë në Kishën Shën Pjetri, Kishë Katolike e Rritit Bizantin.

“Të kujtosh nuk është e mjaftueshme. Ne kujtojmë për të mos harruar, për të mos harruar të shkuarën dhe për të mos harruar detyrën tonë në të tashmen. Ndaj duhet të jemi gjithmonë mirënjohës për komunitetet fetare dhe rolin që ato po luajnë në ndërtimin e një shoqërie të drejtë, paqësore dhe gjithëpërfshirëse,” u shpreh kryetari i bashkisë Elbasan, z. Gledjan Llatja.

“Shqipëria, dhe veçanërisht Elbasani njihet si një model i harmonisë fetare. Është pikërisht meritë e këtyre komuniteteve dhe e kulturës qytetare që e mundëson një gjë të tillë, e konkretizuar në një model suksesi si Qendra e Bashkëpunimit Ndër-Fetar me të cilën e organizojmë këtë ceremony”, theksoi kryetarja Sula.

PUNA PËRGATITORE PËR DIALOGUN E TIRANËS EKPOZITË DOKUMENTARE DHE SIMPOZIUM



Autoriteti dhe partnerët, Shoqata “Tirana”, Instituti i Historisë, UET dhe Bashkia Tiranë vijuan takimet e punës për përgatitjen e Dialogut të Tiranës, me ekspozitë dokumentare, mbledhje të dëshmimeve gojore, studim në dosje të Sigurimit të Shtetit, botime, faqe interaktive...

Me mbështetjen e gjerë të komunitetit dhe të Bashkisë Tiranë, u organizun punët për aktivitetin lançues të datës 18 nëntor në Pallatin e Kongreseve.



Autoriteti dhe partnerët, Shoqata Tirana me mbështetjen e Bashkisë, Instituti i Historisë në ASA, Universiteti European i Tiranës e të tjerët në këtë projekt, mirëpresin ide, sugjerime dhe mbështetje për ndriçimin e gjysmëshekulli histori të Tiranës, ku u luajtën fatet e familjeve auto-ktone dhe të të gjithë vendit.

TIRANA NË SYTË E SIGURIMIT

EKSPOZITË DOKUMENTARE ME MATERIALE MBI TIRANËN QË HAPEN PËR HERË TË PARË...



Ekspozita arkivore me materiale që hapen për herë të parë, ngre siparin e aktiviteteve të Dialogut për Tiranën, - projekt i Autoritetit me bashkëpunimin e Shoqatës "Tirana", Institutit të Historisë, ASA dhe Universitetit Europian të Tiranës, me mbështetjen e Bashkisë Tiranë, - mbi gjysmëshekullin kur kryeqyteti u survejua, u përdoq dhe u shtyp nga regjimi komunist.

Ekspozita dokumentare u zhvillua me praninë e zgjeruar të bashkësisë, studiuesve, historianëve, institucioneve publike, qendrore e vendore dhe organizatave joqeveritare, përfaqësuesve të komuniteteve fetare, grupeve të interesit, trupit diplomatik dhe të rinjve dhe Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, znj. Lindita Nikolli.

8200 fletë të dhjetëra dosjeve ORV të Sigurimit, - që zbërthejnë psikologjinë e regjimit dhe të shtypjes në diktaturë, - janë deklasifikuar në kuadër të ekspozitës, veç dosjeve të tjera, të vëna më herët në dispozicion të familjarëve, studiuesve dhe medias.



Materialet janë pjesë e Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Dega IV, Fondit operativ, Fondit ish-Drejtoria II-të, Të Arratisurit, etj.

Mes tyre, dosje formulare, O.R.V., si Hotel Tirana, Rinas, Kombinati, Kinostudio "Shqipëria e Re", Teatri i Operas, Hotel "Dajti", Uzina "Dinamo", Pallati i Kulturës Masive, Instituti i Studimeve dhe Projekteve, Kombinati i Drurit "Misto Mame", N. Sh "Buka", e shumë të tjerë po ashtu, fashikuj, dosje drejtimi e regjistra përpunimi, të dhëna e statistika të ish-Sigurimit të Shtetit.



Ekspozita dokumentare me materiale të ish-Sigurimit të Shtetit për Tiranën u vizitua gjatë ditës, nga qytetarët, të rinjtë e shkollave dhe të interesuarit që u njohën me detaje me materialet arkivore të prezantuara.

TIRANA NË SYTË E SIGURIMIT

CERMONI PREZANTUESE E PROJEKTIT KËRKIMOR DHE EDUKUES PËR TIRANËN

Dialogu i Tiranës dhe fazat nëpër të cilat do të kalojë projekti përkatës, u prezantuan nga Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, Kryetari i Shoqatës “Tirana”, z. Arben Tafaj, nënkryetari i Bashkisë Tiranë, z. Andi Seferi dhe Drejtori i Institutit të Historisë, z. Afrim Krasniqi.



Sipas kryetares Dr. Gentiana Sula, “kujtesa i bën bashkë, historianët, studiuesit, familjet, institucionet, arkivat. Duke mbështetur bashkëpunime të tilla, secili aktor luan rolin e vet të rëndësishëm në poroçeset përkujtuse”. Dr. Sula bëri një paraqitje të detajuar të survejimit të Tiranës nga Sigurimi, shoqëruar me statistika, grafikë dhe të dhëna mbi dokumentacion zyrtar të administruar nga Autoriteti. Sipas z. Tafaj, kryetar i Shoqatës “Tirana”, “ky qytet ka shumë histori për treguar dhe ne duhet të krijojmë kushtet që e vërteta të dalë në shesh. Ajo të bëhet e njohur për të gjithë, shoqërinë, të rinjtë ata që kanë zgjedhur të jetojnë e rrisin fëmijët e vet në Tiranë”.

Z. Andi Seferi, nënkryetar i Bashkisë Tiranë, mbështetëse e projektit për studimin e gjysmëshekulli në shtypje të kryeqytetit të vendit, e vuri theksin te rëndësia e nis-mave të tilla, që i bëjnë të gjithë bashkë. Z. Seferi pranoi përgjegjësinë e Bashkisë dhe tregoi gatishmëri në vlerësimin e figurave e personaliteteve, në vendosjen e

pillakatave dhe emrave të rrugëve, shkollave e shesheve, duke u mbështetur në propozimet e komunitetit dhe të shoqatave. “Është e rëndësishme që arkivat të hapen, të studiohen dhe botimet e rëndësishme që i kryqëzojnë studimet mbi arkivat, të jenë produktet serioze të bashkëpunimeve të tilla”, u shpreh z. Afrim Krasniqi, drejtues i Institutit të Historisë, ASA. Kryetarja e Komisionit të Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë, znj. Klotilda Bushka, si deputete dhe si qytetare e Tiranës nënvizoi rëndësinë e ligjit “ Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, sipas të cilit, “i nënshtrohet mbrojtjes së veçantë, si pasuri kulturore, pas deklaramit, edhe... vendet e pushkatimit dhe vendvarrimet e fshehta gjatë periudhës komuniste”. Ruajtja e vendeve të tilla është një hap në punën me të pagjeturit e komunizmit.



Z. Genti Kruja, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë bëri një paraqitje të klerit të dënuar, përndjekur dhe ekzekutuar nga regjimi, që ditët e para të instalimit të tij, duke mbështetur studimin e thelluar të figurave të tilla, në Tiranën kryeqytet. Në emër të komunitetit, pjesëtarë të nderuar të familjeve tiranase që pësuan përndjekjen, znj. Afërdita Dalliu dhe z. Xhimi Begeja, shprehën qasjen e tyre ndaj pro-

jektit dhe përvojën personale të përndjekjes. Paola Pesjaka, studente e ekselencës, foli në emër të të rinjve dhe mundësisë së tyre për t’u përfshirë e angazhuar.

Znj. Marsida Najdeni, përfaqësuese e familjeve tiranase, e cila kontribuon gjerësisht në njohjen me figu-



rat dhe personalitetet vendase, e përshëndeti takimin nga SHBA, ku jeton aktualisht, me mesazhin e ruajtjes së vlerave të së shkuarës, bashkimit dhe investimit së brendshmi për një Tiranë të të gjithëve. Paneli i dytë i studiuësve dhe historianëve, - mes të cilëve, Prof. Dr. Nevila Nika, Prof. As. Dr Sonila Boçi, drejtuese e ekipit, Dr. Gjon Boriçi e Dr. Hasan Bello, Instituti i Historisë, dhe Irida Vorpsi, - prezantoi projektin mbi Tiranën, i natyrës kërkimore dhe të edukimit qytetar për demokraci, që do

të zhvillohet në disa etapa, duke nisur me kujtesën historike deri në hapa konkretë përkujtues. Partneriteti me historianët dhe bashkësinë, po ashtu me institucionet dhe organizatat vendore, garanton hulumtimin e materialit voluminoz arkivor dhe botime të dedikuara të profileve të personaliteteve dhe ngjarjeve historike, mbledhje të dëshmime gojore, ekspozita, ruajtje të vendeve të kujtesës, emërtim të shkollave, rrugëve, sheve, dhe vendosje të tabelave përkujtimore në të gjithë qytetin, vlerësim me tituj nderi, si bashkëveprim i të gjithë aktorëve me komunitetin, nga krijimi i burimeve serioze studimore mbi të shkuarën, te vëmendja ndaj atyre që u përballën me dinjitet njerëzor me shtypjen.

Gjatë aktivitetit u plotësuan kërkesa për informim nga të pranishmit e interesuar dhe u shpërndanë gjerësisht botime të Autoritetit dhe partnerëve.



Ekspozita dokumentare me materiale të ish-Sigurimit të Shtetit për Tiranën u vizitua gjatë ditës, nga qytetarët, të rinjtë e shkollave dhe të interesuarit për njohjen më në detaj me materialet arkivore të propozuara.

Dialogu për Tiranën është ftesë për reflektim, një mundësi që shoqëria, studiuesit dhe institucionet, duke përfshirë të rinjtë, të bashkëpunojnë për të shtuar burimet në ndërtimin e një narrative të re, mbështetur në gjenealogji, historitë lokale, respektin ndaj viktimave dhe lehtësimin e dhimbjeve të tyre, po ashtu nderimin e figurave historike dhe personaliteteve të kryeqytetit, tëurvejuar, përndjekur e të përbaltur nga diktatura.



KONFERENCA NDËRKOMBËTARE “ZHUKJET ME FORCË DHE NË MËNYRË TË PAVULLNETSHME NË KOHËN E DIKTATURËS DHE TË KALUARËS AUTORITARE, SI DHE KONTEKST BASHKËKOHOR: NJË VLERSIM SOCIAL, LIGJOR DHE HISTORIK I POLITIKAVE DHE MEKANIZMAVE TË TRANZICIONIT DHE TRANSFORMIMIT”



Prezenca e OSBE-se në Tiranë, Universiteti i Tiranës dhe Qendra e Drejtësisë Tranzitore organizuan më 13, 14 dhe 15 dhjetor, konferencën ndërkombëtare me temë: “Zhdukejten me forcë dhe në mënyrë të pavullnetshme në kohën e diktaturës dhe të kaluarës autoritare, si dhe konteksti bashkohorë: një vlerësim social, ligjor dhe historik i politikave dhe mekanizmeve të tranzicionit dhe transformimit”, me prani të gjerë ndërkombëtare dhe të institucioneve e organizatave shqiptare të lidhura me çështjen e të pagjeturve të diktaturës.

Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, ditën e parë të punimeve, trajtoi: “Rolin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në çështjen e të zhdukurve gjatë komunizmit”, duke paraqitur kontributin e institucionit dhe orientuar drejt hapave të mëpasme që do ta avancojnë identifikimin, gjetjen dhe përkujtimin e të zhdukurve.



Nga ana tjetër, znj. Ardita Repishti u fokusua në komunikimin publik dhe të dhënat e klasifikuara mbi të zhdukurit në komunizëm, në kontekstin e kujtesës kolektive dhe edukimit për demokraci, bazuar në përvojën e deritanishme të punës së institucionit.

Dr. Valbona Pllaha paraqiti punimin “Gjuha e urrejtjes, mjet dhune i shoqërive nën regjim: gjuha e përdorur në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 1945-1990”, mbështetur në

dokumentet e makinerisë së shtypjes.

Autoriteti është pjesë e bordit këshillimor të Qendrës së Drejtësisë Tranzitore dhe mbështet studimet mbi dokumentet që ruhen në arkivat e tij, studime që hedhin dritë në të shkuarën dhe ndihmojnë zbardhjen e saj.

Po ashtu, nga viti 2020, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është ngarkuar me ligj të trajtojë çështjen e të zhdukurve në diktaturë dhe të punojë për qartësimin e fatit të tyre, në bashkëpunim me institucione të tjera qendrore dhe vendore.

NJOHJA NXIT STUDIMIN

Konferenca ndërkombëtare shkencore: “Të mohuar nga regjimi: burgjet, sistemi i internim - dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri 1945-1990”



Tre vjet më parë, i mbështetur nga partnerë e bashkëpunëtorë vendas dhe të huaj, Autoriteti zhvilloi konferencën e parë ndërkombëtare shkencore: “Të mohuar nga regjimi”: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri 1945-1990”, organizuar në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Institutin për Integrimin e ish të Përndjekurve Politikë.

Konferenca trajtoi për herë të parë, në mënyrë tërësore, problematika të shoqërisë shqiptare në raport me të shkuarën komuniste, në një kohë kur opinioni publik tregonte një lloj refuzimi për t’u përfshirë në debate mbi dhunën shumëplanëshe që ushtronte regjimi ndaj kundërshtarëve politikë dhe familjeve të tyre, mbi sistemin e burgjeve dhe atë të internim/dëbimeve, mbi vuajtjet e njerëzve në këto burgje e kampe dhe keqtrajtimet e shumta që pësuan.

Gjatë 30 viteve që pasuan rënien e regjimit komunist në Shqipëri, komuniteti i studiuesve nuk ka qenë shumë i fokusuar në këto çështje. Në Shqipëri mungonin studime serioze mbi punën e detyruar dhe sistemin e internim-dëbimeve; ende sot mungojnë vende të kujtesës; nuk ka pasur aktivitete të mirëfillta shkencore mbi këtë tematikë dhe, vetëm së fundi, është koordinuar një punë sistematike nga aktorët e kujtesës, si për mbledhjen e dëshmimeve dhe kujtimeve të personave që kanë vuajtur në burgjet dhe kampet e internimit, ashtu edhe për dokumentimin e tyre dhe komunikimin e gjetjeve publikut.

Konferenca “Të mohuar nga regjimi: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri 1945-1990” u finalizua me botimin përkatës me përmbledhje të kumtesave

‘Çamët e pabesë’ si kundërshtarë politikë të regjimit komunist

Rasti i disidentit Bilal Xhaferri

Studimi u përgatit nga Ilir Ademaj, në kuadër të në kuadër të konferencës ndërkombëtare shkencore të AIDSSH me ASA, ISKPK, IIPP, Muzeun Historik Kombëtar, “Fytyra e armikut të popullit”

PROFILE TË
“ARMIKUT TË POPULLIT”
NË DIKTATURË



KONFERENCË NDERKOMBËTARE SHKENCORE

Përgjatë regjimit komunist, janë tri etapa që e ndajnë gjendjen socio-politike të shqiptarëve të Çamërisë: 1) 1944-1953 2) 1953-1960 dhe 3) 1960-1992. Në këta tri kapërcyej, regjimi komunist i frymëzuar nga modelet e pogromeve përndjekëse nga Moska e Beogradi, krijoi profile të ndryshme të “armikut të popullit” brenda komunitetit të shpërngulur çam por edhe ndaj shqiptarëve të Çamërisë administrative (Rajoni i Konispolit) sot brenda Republikës së Shqipërisë. Duke qenë se Çamëria shtrihej në dy shtete administrativ, respektivisht ai shqiptar dhe grek, komuniteti i sapoardhur nga shteti grek, u trajtua nga organet qeveritare si kundërshtar dhe i papërshtatshëm për të luftuar besnikërisht e denjësisht luftën e klasave. Ekzistojnë disa tipologji dhe dukuri shoqërore që shfaqen tek ky komunitet si

pasojë e zhvendosjes së tyre nga vatrat amtare në shtetin shqiptar. Etapa e parë përfshin krizën humanitare të emigrantëve çamë dhe heqjen e shtetësisë dhe etapa e dytë 'Gjyqin e Teme Sejkos' dhe të 'grupit çam'. Rasti i shkrimtarit Bilal Xhaferri si disident politik, i përket etapës së tretë dhe është trajtuar në disa botime sidomos rreth aktivitetit letrar. Nëpërmjet një shikimi holistik të materialit arkivor, lypet që të shikohet rasti i i tij si një pjesëz e implementimit të një strategjie më të gjërë të regjimit të udhëzuar nga doktrina komuniste.



**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Adresa: Njësia administrative nr. 4, Rruga e Dibrës
Garnizoni "Skënderbej", Tiranë
<http://www.autoritetidodsjeve.gov.al>